

AKT- THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“Home Services” shpk

Ne Kavaje, sot me date 27 Janar 2025 (dymije e njezet e pese).

Ortaku i vetem themelues:

Z.David Nagy, i datelindjes 02/06/1994, lindur ne Hungari dhe banues ne Tiszaszolos , shtetas Hungarez madhor, me zotesi juridike për të vepruar identifikuar me leternjoftim ID 241635he dhe numer personal 241635he , me cilesine e “Ortakut themelues” kerkoi redaktimin e ketij akti themelimi, nepermjet te cilit deklaroi se me vullnet te lire te plote e te sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregetaret dhe shoqerite tregetare”, ligjin nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne ate Doganor,Fiskale Tatimor, krijon shoqerine tregetare, me pergjegjesi te kufizuar, **Home Services” shpk**

KREUI

Neni 1

Krijimi

“Home Services” shpk

Eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria **Home Services” shpk**, eshte nje shoqeri tregetare, e themeluar nga shtetasi Hungarez **Z.David Nagy**, i cili pergjigjet per detyrimet e shoqerise tregetare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkuara. Kontributi i ortakut perben kapitalin e regjistruar te shoqerise.



Neni 3

Selia

Shoqëria e ka seline në Tirane Kavaje Qerret ,objekt me Nr pasurie16/55+2-n3 dhe Zone Kadastrale 3101. . Shoqëria mund të ndryshoje seline e saj , te hapë zyra përfaqësie, degë, të krijoj filiale, si brenda dhe jashtë vendit Republikës së Shqiperisë , vetëm me vendimin e Ortakut themelues .

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Apartamente dhe makina me qera

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

KREU II

Kapitali

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njqind mije) leke, i ndare ne 1 kuote me vlere nominale 100.000 (njqind mije) leke, i nenshkruar plotesisht nga ortaku vetem themelues ne masen 100%. Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregetueshme. Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme te paluajtshme apo te drejta). Ortaku vetem pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te kapitalit themeltar te shoqerise.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuota e kapitalit tenje shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen repermjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërise për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendren Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashegimie.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Ortaku i vetëm është organi vendimmarres i shoqërise. Ortaku i vetëm është organi vendimmarres i shoqërise që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statute duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërise.

Ortaku vendos për çështje si :

- a) Përcaktimi i politikave tregëtare të shoqërise
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- c) Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar



- d) Percaktimin e shperblimeve
- e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- g) Miratimin e rregullave procedural te mbledhjeve te asamblese;

Te gjitha vendimet e marra nga ortaku vetem regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne vecanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per :

- a) Miratimine pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim , pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqerise "**Home Services**" shpk, caktohet **Z.David Nagy**, i cili emerohet per nje afat 5 vjeçar me te drejte ripertitje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te vetem themelues te shoqerise.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka te drejte e detyrohet te :

- a) Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoqrise, duke zbatuar politikat tregetare, te vednosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) Perfaqesojë shoqerine tregetare;
- c) Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d) Pergatise dhe nenshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve i paraqesin keto dokumenta perpara asamblese se pergjithshme per miratim

- e) Krijoi nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f) Kryej regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqrise sic parashikohet ne ligjin per QKR.
- g) Raportoi perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregetare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregetare.

Administratori eshte i detyruar te therrase ne mbledhjen e asamblese ne rastet kur :

Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Administratoret, se bashku edhe vecas njeri tjetrit, kane te drejte te kryejne te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtzakonshem. Administratoret e perfaqesojne Shqiperine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkalleve. Administratoret kane te gjitha kompetencat per te vepruar ne mardhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ja jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratoret angazhojne shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj. Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose per te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk esht prove e mjaftueshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti Financiar i shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor. Perjashtimisht, viti i parefinanciar fillon nga data e regjistrimit te shkoqerisë ne QKR dhe mbyllet ne 31 dhjetor.

Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqeris mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj
- b) me vendim te ortakve themelues
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit



- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk esht njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombtare te Regjistrimit"
- e) me vendim te gjykates

Ne kete rast Asambleja merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqeris, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo document te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " shoqeri ne likuidim e siper".

Neni 13

Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjiit "Per tregtaret dhe shoqerit tregtare", Kodit Civil dhe cfar do ligji tjeter specific ne Republiken e Shqiperis

Neni 14

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njejta juridike.

Akti i mesiperm pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare Shpk, nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij origjinale .

ORTAKU I VETEM THEMELUES

David Nagy

DAVID NAGY

